



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. 2177 Prot.

**BASHKIA BELSH  
KËSHILLI BASHKIAK**

Belsh më: 28/06/2024

**NJOFTIM PER SHTYRJE TË KONSULTIMIT PUBLIK**

Bazuar në ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18 pika 1 dhe pika 2, neni 54 germa (e) dhe në Rregulloren e Brendshme për funksionimin e Këshillit Bashkiak neni 158, nisur dhe nga anulimi i takimeve të planifikuara për konsultim publik më datë 20.06.2024 për shkaqe objektive, Këshilli Bashkiak Belsh:

*Fton banorët e fshatrave Hysë, Seferan, Kosovë dhe Dëshiran të bëjnë sygjerimet e tyre lidhur me projekt-vendimin e mëposhtëm:*

**Projekt-vendim për dhënien në përdorim të pasurive :**

1. Pasuria A pjesë e pasurisë nr.185/1,ZK. 1146 me sipërfaqe 77000m2 me certifikatë pronësie të lëshuar më datë 06/11/2020 Nr. 21340 në pronësi të Bashkisë Belsh
2. Pasuria A pjesë e pasurisë nr.1/179, ZK.2237, me sipërfaqe 162 050m2 me certifikatë pronësie të lëshuar më datë 18/12/2023.
3. Pasuria C pjesë e certifikatës së pronësisë me nr. Pasurie 42/3, ZK 1478 me sipërfaqe 30ha.
4. Pasuria A pjesë e certifikatës së pronësisë me nr.pasurie 42/3,ZK 1478,me sipërfaqe 46.25ha
5. Pasuria B pjesë e pasurisë Nr.122/1,ZK.3272, me sipërfaqe 16 264m2

**(Paraqitur nga Drejtoria e zhvillimit të bujqësisë, pyjeve dhe mjedisit)**

Konsultimi publik do të bëhet më datë 01.07.2024 për të 4 fshatrat në një ambient të përbashkët në lagjen Hysë , Ora: 11:00 , Vendi Takimit: **Lokali i Lulzim Pepes**

Drejtues të takimit do të jetë Komisioni i Bujqësisë dhe Pyjeve në këshillin Bashkiak Belsh me përbërje si mëposhtë:

1. Aleksander Peqini, Kryetar
2. Nexhip Elezi , Anëtar
3. Fadil Zdrava, Anëtar

Gjithashtu ju ftojmë të bëheni pjesë e dëgjësës publike për projektvendimin e mësipërm nëpërmjet sygjerimeve tuaja në adresat elektronike:

<http://bashkiabelsh.al/bashkiabelsh@hotmail.com>

**KRYETARI I KËSHILLIT  
Kujtim DERVISHI**

